





# KËSHILLA për sigurinë gjatë rrugëtimit për në SHKOLLË



## Planifikoni rrugën

Planifikoni rrugën më të sigurt me fëmijët për në shkollë. Rishikoni emrat e rrugëve dhe orientimet për të mos u humbur.

01



## Rregullat e rrugës

Së bashku me fëmijët mësoni shenjat e trafikut – për shembull, luanilojëra për të njohur kuptimin e tyre.

02



## Shikoni mirë

Mësojuni fëmijëve të sigurohen që automjetet janë ndalur para se të kalojnë rrugën. Kontakti me sy me shoferët është i rëndësishëm.

03



## Dëgjoni

Largoni kufjet apo pajisjet që mbulojnë dëgjimin gjatë ecjes – zërat e trafikut janë sinjale paralajmëruese.

04



## Bëhuni të dukshëm

Sigurohuni që fëmija të veshë rroba me ngjyra të ndritshme ose reflektuese, veçanërisht në ditë me shi apo errësirë.

05



## Jepni shembull të mirë

Mos kaloni rrugën në vende të pasigurta dhe përdorni gjithmonë dritën e gjelbër për këmbësor në semafor apo vijat e bardha të shënuara në rrugë.

06



## Makina të parkuara

Shmangni ecjen në mes të makinave të parkuara – drejtuesit mund të mos i shohin fëmijët që kalojnë.

07

